



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

A K T N O R M A T I V

Nr. _____, datë _____

PËR

NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa, me këtë përmbajtje:

Neni 1

Në kreun XV “Dispozita tranzitore dhe të fundit”, pas pikës 7, të nenit “Dispozita kalimtare”, shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

“8. Përjashtimisht parashikimeve në këtë ligj, zbatimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative që lidhen me zbatimin efektiv të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, do të fillojë të aplikohet pas datës 30.6.2022, për tatimpaguesit, si më poshtë:

- a) Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, të cilët kryejnë vetëm shitje me para në dorë kundrejt konsumatorëve finalë, persona të patatueshëm;
- b) Tatimpaguesit që ofrojnë furnizimin me ujë për konsumatorët finalë, si dhe tregu i rregulluar i energjisë elektrike;
- c) Bankat apo institucionet financiare për njoftimin e pagesave të e-Faturave të lëshuara nga subjektet tatimpaguesE.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ